

E DIELA E RUSHAJEVE

THIRRTORET, T. I.

Këndohen dhjetë, dyke përsëritur të parën dhe të pestën:

Kremtojmë Rushajet, edhe ardhjen e Shpirtit, edhe ditën e zotimit, edhe mbarimin e shpresës. O sa mister i math edhe i shenjtë! Përandaj po të thërresim: O Zot o krijetar i gjithësisë, lavdi më ty. (2 herë)

I përsërite me gjuhë të huaja, dishepujtë e tu o Zot, që me anën e tyre të lëçitim, ty Fjalën e pavdekur dhe Perëndi, që u fale shpirteve tona, përdëllimin e math.

Shpirti Shenjt i përndan të gjitha dhuratat: Buron profetira, dorëzon priftërinj, u fal urtësi të paditurve, i

bën peshkatarët theollogë, e përmbledh kanunin e tërë të Kishës. O Ngushëllimtar i bashkëqënsim, dhe i bashkëfronshim me Atin, dhe me Birin lavdi më ty.

T. II. Pamë dritën e vërtetë, muarmë frymën qjellore, gjetmë besën e vërtetë, dyke adhuruar Trinin' e pandarë, se ajo na shpëtoj. **(2 herë)**

Me Profetët na tregove udhën e shpëtimit, edhe me anën e Apostujve, na dërgove dritën edhe hirin e Shpirtit të Shenjtë, o Shpëtimtari ynë. Ti je i pari Perëndi, edhe ti je i pastajmi, edhe ti je Perëndia ynë për jetë.

Në hoborret e tua do të hymnonj, o Shpëtimtar i botës, edhe do të bie më gjunjë, edhe do ta adhuronj fuqinë tënde të pamundur, mbrëmane dhe në mëngjes dhe më drekë, edhe më çdo kohë do të bekonj o Zot.

Nër hoborret e tua o Zot, përgjunjemi me mish e me shpirt, edhe përhymnojmë Atin e panismë, edhe Birin e bashkëpanismë, edhe Shpirtin e tërëshenjtë, që ndriçon edhe shenjtëron shpirtet tona.

Le ta përhymojmë Trininë e bashkëqënsime, Atin edhe Birin edhe Shpirtin Shenjt, se kështu kanë lëçitur Profetët, edhe Apostujtë edhe Dëshmorët.

LAVDI DHE TANI. Ejani o popuj, le ta adhurojmë Perëndinë, Atin edhe Birin edhe Shpirtin e Shenjtë, Ngushëllimtarin, që dërgohet prej Atit, edhe prëhet më Birin. Trini e Shenjtë, lavdi më ty.

PAREVARGU I MBREMES, T. II.

Zoti mbretëroj, u-vesh me madhështi.

PASVARGJET, T.T. II.

Kombet kujtonin, që Apostujtë ishin të dehur, kur flisnin gjuhë të huaja, se nukë dinin që atë dhuratë, e kishin marrë nga Shpirti i Shenjtë; po ne e dimë dhe thërresim: O Zot që u-çfaqë mi dhenë, dhe na shpëtove prej errësirës lavdi më ty.

Frymësimi i Shpirtit të Shenjtë u-dukej paganëve si dehje, neve besnikëve, na solli shpëtimin. Pra vlerësona për dritën e tij, o njeridashës të lutemi.

O Mbret qjellor, o ngushëllimtar, o shpirti i së vërtetës, që ndodhesh kudo, dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe falës i jetës, eja dhe tendëso nër ne, dhe spastrona prej çdo njolle, dhe shpëtoji shpirtet tona, o i mirë.

LAVDI DHE TANI, T.T. IV

Gjuhët u-përzien një herë, nga shkaku i ndërtimit të kështjellës; tani gjuhët u-mësuan, për lavdinë e Perëndisë. Ahere Perëndia i dënoj, të pabesët për mëkatat; tani Krishti i ndriçoj, peshkatarët me anën e Shpirtit të Shenjtë. Ahere u-bë mosmarrëveshja si punitje; tani u-përsërit marrëveshja, për shpëtimin e shpirtëve tona.

PERLESHORJA E RUSHAJEVE, T.T. IV

Je i bekuar o Krisht Perëndi dhe Zot, që i çfaqë, Shën Apostujtë peshkatarë, më të urtët e botës me Shpirtin Shenjt, dhe me ata, rjetove dhenë anëmbanë, njeridashës lavdi më ty.

NDENJESORET, T. IV.

PAS KATEPLLAJI IOSIF

Me gëzim kremtojmë sot, ditën e Shpirtit Tërë-

shenjt, o besnikë me lavdi, dit' e Rushajes është kjo, që na mbaroj çdo shpres' e çdo zotim të perëndishmë; se zbriti me rrebesh, ngushëllimtari mi dhe, si gjuhë flag' e zjarr, shkrep mi kokën e kujtdo, dhe Apostujt' i bëri dishepuj të Perëndisë. Ardhi drita, Ngushëllimtari, edhe ndriti botën.

LAVDI DHE TANI. **Gjithajo.**

Shpirti Shenjt buroj mi dhe, vala prej zjarri shpirtërisht, dhe në botën u-përhap, si lum i qjellit plot me hir, dhe i ndriçoj Apostujtë me bes' e me shpresë; dhe zjarri përmi ta, si prej vese u-bë, dhe i ndriti i mësoj, flaga që binte si shi, dhe prej atyre muarmë hirin me zjarr dhe me ujë. Ardhi drita, Ngushëllimtari, edhe ndriti botën.

LAVDI DHE TANI, **Gjithajo.**

PAS TO PROSTAKHTHEN MISTIKOS, T.T. IV

Passi u-ngjalle, i tridiçim prej varrimit, dhe fluturove, lart në qjell me Shestjen tënde, u dërgove dishepujve lavdi dhe bujë. Dhe mëndjen, ua ndriçove me Shpirtin Shenjt, dhe zërin, ua forcove mistikërisht, dhe buçitnë kudo mi dhe, me trumbet' e burazan, fjalën tënde o Zoti Krisht, dhe hirin e Ungjillit tënt.

LAVDI DHE TANI. **Gjithajo.**

SHKALLESA KREMTORE, T. IV.

Që prej djalërisë, shumë pasione më lëftojnë, po ti përkrah-më dhe shpëto-më, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionën, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të fishkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njësisë trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin buriemet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetëlindje.

PAREVARGU: Shpirti yt i mirë do ma tregonjë, udhën e drejtësisë. Dëgjoje faljen time, o Zot. (**3 herë**)

Ungjilli Mëngjesor IX (shiko Kremtoren f. 148-150), dhe pas Ungjillit menjëherë thuhet pa zë Psalmi 51; pastaj:

LAVDI. Me nërmjetimet e Apostujve, o mëshirëplot, shuaji paudhësit' e mia.

TANI. Me nërmjetimet e Hyjlindëses, o mëshirëplot, shuaji paudhësit' e mia.

Mëshiro-më, o Perëndi mëshirëplot, edhe shuaji paudhësit' e mia.

O Mbret qjellor, o ngushëllimtar, o shpirti i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe falës i jetës, eja dhe tendëso nër ne, dhe spastrona prej çdo njolle, dhe shpëtoji shpirtet tona, o i mirë.

SHKURTORJA, T.T. IV.

OTE KATAVAS

Zbriti dhe përzjeu gjuhët e njerësve, i përçau paganët i Larti Zot; gjuhë zjarri kur u fali dishepujve, në bashkimin e shenjtë të gjith' i ftoj; me një zë lavdërojmë pra, Shpirtin Shenjt me Trininë.

SHTEPIA

Ep-na ngushëllim të shpejtmë, o Jesu; mos u-ndaj

prej shpirtëve tona nër hidhërimet; mos u-largo prej mëndjeve tona në reziket; po përkrahna përherë; a-frona-u, afrona-u, ti që ndodhesh kudo, ashtu siç ishe gjithënjë me Apostujtë, që ta hymnojmë, dhe ta lavdërojmë Shpirtin Shenjt me Trininë.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Tettë pas Pashkës së Madhe, kremtojmë Rushajet e Shenjta.

Me nërmjetimet e Shën Apostujve, o Krisht, o Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

Pastaj këndohen Zbritesoret Dyplike:

A. THIO KALIFTHIS, T. IV.

B. PONTO EKALIPSE, T.R.

I-A. Mjegull e mbuloj bëlbëcakun në malin
Kur e proklamoj ligjën e Perëndisë;
Se e hodhi tej errësirën e mëndjes,
E pa të Lartin dhe prej Shpirtit i ndriçuar
Mori dijën dyke lavdëruar Zotin.

I-B. Zoti e mbyti krejt Faraonin mun' në det, si i fortë në luftë, i ra me krahun e dërmoj; thirrini ati: O Zot lavdi më ty.

III-A. Lithmën e çliroj të beronjës pa foshnjë,
Talljen e pëllores me fëminjë shumë
E pushoj një herë Profetesha Anna
Me të falura me frymë të dërmuar
Përpara Perëndisë Zotit të mëshirës.

III-B. Me fuqi që lartazi, gjer sa të visheni, në Jeru-

salem qëndroni, u the dishepujve o Zoti Krisht; dhe unë ju dërgonj zëvendës si unë, Shpirtin tim dhe t' Atit tonë si Ngushëllimtar, si forcë, dhe si shigurim.

IV-A. Mbret i mbretërve dhe Bir i vetëmlindur,
Fjal' e Perëndi prej Atit të panismë,
Shpirtin e bashkëfuqishm' e të pavdekur
U dërgove Apostujve për lëcitjen
Dhe ata këndonin: Zot lavdi më ty.

IV-B Kur e mori vesh Profeti, që do të zbreç mi dhe o Krisht, me gëzim të thërriste: Kam dëgjuar për çudinë që ke përgatitur, se vjen për të shpëtuar, të mirët dhe besonjësit.

V-A. Ndjes' e paqësim për fajë dhe mëkata
Prisni prej Shpirtit vesën e frymëzjarrtë,
Bij të Kishës me fytyrë të ndriçuar,
Se tani na dolli ligja nga Siona,
Hir' i Shpirtit Shenjt me gjuhëra prej zjarri.

V-B. Fryma jot' e shenjtë shpëtimtare o Zot, Profetët i frymësoj, dhe lindi pasandaj mi dhe, ka krijuar zëmra të kthjellëta apostolike, dhe të drejta përsërit midis besnikëve, se porrosit' e tua janë, dritë dhe paqe gjithënjë.

VI-A. Që të na shpëtosh e të na ndjesh mëkatat
Linde përmi dhe si Zot prej Virgjëreshës
Dhe si Profetin Shën Jona prej mushkërive
Të balenës e shpëton edhe njerinë
Të rrëzuar dhe të mbytur nga mëkatat.

VI-B. Po më merren mënttë, nga andrallat jetësore, dhe mbytem nga fajet dhe mëkatat, jam përpirë prej balenës shpirttrëmbenjësë, dhe si Jonaj o Krisht të kam thirrur: Nxir-më nga avusha vdekjeprurësë.

VII-A. Krisi me një zë një këngë me strumenta
Për adhurimin e statujës njerëzore;
Po Ngushëllimtari na ndriçon me hir
Edhe na fton të themi: O Trini e vetëm,
E shenjtë, e panisme, e bekuar je.

VII-B. Tre Djemat që përbuznë një tiran, dhe u-hoth-
në në furrë, e bënë flagën flladitëse, dyke kënduar edhe
dyke thirrur: O Perëndi i Atërve, i bekuar je përherë
dhe për jetë.

VIII-A Çdo zinxhir e zgjith edhe çdo flag' e shuan
I tridritëshmi simbol i Perëndisë.
Hymnojnë Djemat dhe e bekojnë Zotin,
Shpëtimtarin Krijetar si mirëbërës
Gjithë veprat që i ka krijuar vetë.

VIII-B Ferra e padjegur në Sina, i çfaq i Perëndinë,
Profetit Moisi gjuhëlidhur dhe vesh-rëndë, dhe Djemat
plot me zell për Perëndinë, u-bënë të padjegur dyke
thirrur. Gjithë krijesat e Zotit e bekonin, dhe e lartësonin
përherë dhe për jetë.

DHJAKU: Hyjlindjësën dhe Mëmën e Dritës, me
hymne nderimi le ta madhështojmë.

Pastaj Vallet këndojnë:

IX-A. *Engjëjtë, kur panë Shestjen e Zotit, çuditëshin dhe
shtangëshin, qysh me lavdë fluturonte, që prej dheut me të
lartat.*

O Hyjlindëse Virgjëreshë dhe Nënë,
Gjuha më e mprehtë dhe oratorike
Nukë munt të të këndonjë pas vlerës,
Dhe vertikohet mëndja për lindjen tënde;
Pra, me një zë të gjithë të lavdërojmë.

IX-B. Ty që na linde Shpëtimtarin virgjërisht, që
mishërove dhe rrite Fjalën çuditërisht, Zonjë Hyjlindë-
se, dhe Nënë Virgjëreshë, o en' e të panxënit, o streh' e
Krijetarit të pakulmë, të madhështojmë sot.

DERGIMESORET, T. III.

PAS EPESKEPSATO IMAS

Ti o Shpirti Tërëshenjt, që At' i Shenjtë të dërgoj, kur
i Biri nërmjetoj, mi Apostujtë pa mësim; ata që ty të
quajnë, të tretin e Trinisë, shpëtoji me hirin tënt. (2
herë)

Dritë Ati dritë Fjal' e tij, dhe dritë është Shpirti
Shenjt, që si gjuhë flag' e zjarr, mi Apostujtë zbriti sot;
dhe me ata u-ndriçuan, besnikët t' adhurojnë, Trininë
si Perëndi.

LAVDERIMET, T. IV.

Këndohen gjashtë, dyke i përsëritur që të tria:

Gjëra të çudiçime, panë gjithë kombet në qytetin e
Davidit, kur zbriti Shpirti i Shenjtë në formë gjuhësh
prej zjarri, sikundër thotë Shën Llukaj Ungjillori: Atje
ku ishin mbledhur Dishepujt' e Krishtit, ardhi një oshë-
tim si prej ere të reptë, dhe e mbushi shtëpinë ku rrinin;
dhe nisnë të flasin fjalë të huaja, doktrina të huaja, më-
sime të huaja të Trinisë së Shenjtë.

Shpirti i Shenjtë ishte gjithënjë, është dhe do të
jetë, as nisi as pushon, po është i bashkuar me Atin e me
Birin; i mirë dhe burim i mirësisë, me anën e të cilit
njihet Ati, dhe lavdërohet Biri, dhe leçitet prej të gjithë-
ve, si një fuqi dhe një bashkim, dhe një adhurim i Trin-
isë së Shenjtë.

Shpirti i Shenjtë është dritë dhe jetë, dhe burim i gjallë shpirtëror: Shpirt i urtësisë, i mirësisë dhe i drejtësisë; Shpirt mëndor dhe zotëror, që paqëson mëkatat; Perëndi dhe perëndimtar; zjarr prej zjarri që flet, që vepëron edhe që përndan dhurata; me anën e të cilit u-kurorëzuan Profetët, Apostujtë dhe Dëshmorët. Lajmë e çudiçime, pamje e çudiçime, zjarr që përndahet në pjesa dhuratash.

LAVDI E TANI, T.T. II: O Mbret qjellor, o ngushëllimtar, o shpirti i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe falës i jetës, eja dhe tëndëso nër ne, dhe spastrona prej çdo njolle, dhe shpëtoji shpirtet tona, o i mirë.

Doksollogji e Madhe; pastaj këndohet tri herë edhe gjithashtu tri herë në Hyrjen:

PERLESHORJA E RUSHAJEVE, T.T. IV.

Je i bekuar o Krisht Perëndi dhe Zot, që i çfaqe, Shën Apostujtë peshkatarë, më të urtët e botës me Shpirtin Shenjt, dhe me ata, rjetove dhenë anëmbanë, njeri-dashës lavdi më ty. (3 herë)

HYRTORJA

Lartësohu me fuqinë tënde o Zot; do t'i këndojmë dhe do t'i lavdërojmë çudirat e tua. Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të këndojmë Alilluia.

SHKURTORJA E RUSHAJEVE, T.T. IV.

OTE KATAVAS TAS GLLOSAS

Zbriti dhe përzjeu gjuhët e njerësve, i përçau paganët i Larti Zot; gjuhë zjarri kur u fali dishepujve, në

bashkimin e shenjtë të gjith' i ftoj; me një zë lavdërojmë pra, Shpirtin Shenjt me Trininë.

Në vënt të Hymnit Trishenjtor, këndohet:

Sa u-pagëzuar më Zotin Krisht, u-veshtë me Zotin Krisht Alilluia.

APOSTULLI

Fama e tyre u-përhap në tërë botën.

Qjelli e tregon lavdinë e Perëndisë.

Këndimi prej Akteve të Apostujve.

Edhe kur ardhi dita e Pesëdhjetores plotërisht, të gjithë Apostujtë ishin mbledhur me një zëmër në një vënt. Edhe befas ardhi një oshëtim nga qjelli, si nonjë erë e rreptë, që frynte, edhe e mbushi tërë shtëpinë, ku ndodhëshin. Edhe u-dukne gjuhë si prej zjarri, të cilat u-përndanë edhe u-vëndosnë mi cilindo prej atyre, edhe u-mbushnë me Shpirtin e Shenjtë, edhe nisë të flisnin gjuhë të ndryshme, siç i kishte stërvitur Shpirti i Shenjtë. Edhe ndodhëshin në Jerusalem Judenj, njerës besnikë prej çdo kombi në botë. Edhe kur u-përhap kjo lajmë, gjindja u-mblohnë, dhe u-përziën, se cilido i dëgjonte t'i flisnin në gjuhën e vetë. Edhe të gjithë çuditëshin, edhe habitëshin, edhe i thoshnin njëjtrë: "Shih, a nukë janë Galileanë të gjithë këta, që po flasin? Edhe po i degjojmë cilido në gjuhën, që kemi lindur, Parthianë, Medianë, Ellamitër, dhe banonjës të Mesopotamisë, të Judesë, të Kapadokisë, të Pontit, të Asisë, të Frigisë, të Pamfilisë, të Egjiptës, edhe të viseve të Libisë pranë Kirenës, edhe të huajtë Romanë, Judenj edhe proslitë, Kretanë, dhe Arabër, i dëgjojmë të flasin në gjuhët tona madhështirat e Perëndisë.

UNGJILLI PAS JOANIT

Në ditën e funtme të së Kremtes së Madhe, Jesuj u-ngrit, edhe thirri dhe tha: “Ay, që ka etje, le të vinjë tek unë, dhe le të pinjë. Ay, që më beson, sikundër thotë Shkriptura, do të bëhet burim i ujës së gjallë.” Edhe këtë e tha për Shpirtin, të cilin do ta merrnin ata, që do ta besonin; se Shpirti i Shenjtë nuk ishte dhënë, meqënëqë Jesuj nuk ishte lavdëruar edhe. Shumë, pra, prej popullit, kur e dëgjuan këtë fjalë, thanë: “Me të vërtetë ky njeri është Profeti.” Të tjerë thoshnin: “Ky është Krishti.” Po disa thoshnin: “Mos vjen Krishti prej Galilesë? A nukë thotë Shkriptura se Krishti vjen nga fara e Davidit, edhe nga katundi Bethlehem, ku banonte Davidi?” U-bë, pra, një çarje në gjindjen nga shkaku i tij.

Edhe disa prej atyre deshnin ta zinin, po asnjë nukë vuri dorën mi atë, edhe shërbëtorët u-kthyen prapë në Kryepriftinjtë dhe Farisianët. Edhe këta u thanë: “Përse nuk e prutë?” Edhe shërbëtorët u-përgjeqnë: “Kurrë nonjë njeri nukë na ka folur si ky.” Edhe Farisianët u thanë: “Mos u-gënjet edhe ju? Mos e besoj nonjë prej krerëve dhe prej Farisianëve? Po kjo gjindje, që nuk e di ligjën, është e mallkuar.” Edhe Nikodemi i cili i vinte natën Jesujt, edhe ishte një prej atyre, u tha: “Mos ligja jonë e gjykon një njeri pa e dëgjuar dhe pa ditur seç bën?” Edhe u-përgjeqnë edhe i thanë: “Mos je edhe ti prej Galilesë?” Edhe Jesuj u foli përsëri, edhe u tha: “Unë jam drita e botës. Ay, që më vjen pas, nukë do të baresë në errësirën, po do të ketë dritën e jetës.”

Në “Veçan Tërëshenjtën”, këndohet:

ZBRITESORJA IX, T.R.

IX-B. Ty që na linde Shpëtimtarin virgjërisht, që

mishërove dhe rrite Fjalën çuditërisht, Zonjë Hyjlin-dëse, dhe Nënë Virgjëreshë, o en' e të panxënit, o streh' e Krijetarit të pakulmë, të madhështojmë sot.

KUNGATORJA

Shpirti yt i mirë do ma tregonjë, udhën e drejtësisë. Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të “Pamë Dritën”, këndohet:

PERLESHORJA E RUSHAJEVE, T.T. IV.

Je i bekuar o Krisht Perëndi dhe Zot, që i çfaqë, Shën Apostujtë peshkatarë, më të urtët e botës me Shpirtin Shenjt, dhe me ata, rjetove dhenë anëmbanë, njeridasnës lavdi më ty.

Pas Uratës Përpara Tribunës, këndohet:

Emri i Zotit qoftë i bekuar që tani dhe gjer më jetë. **(3 herë)**

PERLESHIMI

Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, që zbriti nga gjiri prindëror i Perëndisë prej qjellit mi dhenë, dhe u-mishërua për shpëtimin tonë; dhe pastaj u-ngjit prapë në qjell, edhe ndënji më të djathtën e Atit, edhe u dërgoj Dishepujve dhe Apostujve Shpirtin e Tërëshenjtë, edhe me anën e tyre e ndriçoj tërë botën; me nërmjetimet e Shën Marisë; të Apostujve të Shenjtë, të lavdëruar dhe emërshkëlqyer; dhe të gjithë Shenjtorëve; na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës.

Pastaj këndohet Mbrëmësorja me Uratat mëgjunjazi (shiko Uratoren, f. 420-434).